



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. Regj. Them. nr. 5649/1216
Dt. Regj. 01.07.2014

Nr. Vendimi 2017
Dt. Vendimi 30.09.2015

V E N D I M
"Ne emër te Republikës"

Gjykata Administrative e Apelit me trup gjykues te përbërë prej:

Kryesuese:	Rilinda SELIMI
Anëtare:	Alkelina GAZIDEDJA
Anëtare:	Blerona HASA

me sekretare gjyqësore **Afede RUNAJ**, ne Tirane, sot me date 30.09.2015 mori ne shqyrtim ne dhome këshillimi çështjen administrative nr. 5649/1216 akti, dt. Regjistrimi 01.07.2014 qe u përket palëve ndërgjyqëse:

PADITËS: Shoqëria "Çeliku" sh.p.k. Fier.

E PADITUR: 1. Drejtoria Rajonale Tatimore Fier.
2. Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve Tirane.

OBJEKTI: Shfuqizim i aktit administrativ Nr.6939 datë 13.10.2011, i palës së paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, për shumën 100.000 lekë, pezullimi i zbatimit të tij, si dhe ndryshimi i aktit nr.13185/3 datë 10.09.2012, të Drejtorisë së Apelimit Tatimor Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 324/a, 329 të K.Pr.Civile, neni 106 e vijues të ligjit 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore", neni 65 i K.Pr.Administrative, neni 17 i ligjit 10279 datë 20.05.2010 "Për kundravajtjet administrative" në lidhje me nenin 122 të ligjit 9920 datë 19.05.2008 (ndryshuar me ligjin 10209 datë 23.12.2009).

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin Nr. 62-2012-6115(2102), datë 30.10.2012 ka vendosur:
"Rrëzimin e padisë.."

Kundër këtij vendimi ka bërë ankim në Gjykatën e Apelit Vlorë, pala paditëse Shoqëria "Çeliku" sh.p.k. Fier, duke paraqitur këto shkaqe ankimi:

- Gjykata ka rrezuar padrejtësisht padine per paraqitje te apelimit tatimor jashte afatit duke zbatuar gabim nenin 109 te ligjit 9920. Dt. 19.05.2008 ne lidhje me nenin 106.2.2 te udhezimit te m.financave nr 24,dt 02.09.2008 e nenet 64-65 te K.Pr. Administrative.
- Gjykata megjithese ka bere 7 faqe vendim vetem ne 4 fjalite e fundit te tij ka arsyetuar per rrezimin e padise. Konkretisht ajo e ka rrezuar padine si padi qe smund te ngrihej per shkak se apelimi tatimor eshte bere jashte afatit e se "pala paditese nuk ka kerkuar me padi rivendosjen

ne afat sipas nenit 109 te ligjit 9920, dt. 19.05.2008 e nenet 64 e 65 te K.Pr.A."

- Ky arsyetim i Gjykates vjen ne kundershtim te hapur me gjendjen faktike te Pranuar edhe nga vete Gjykata ne faqet 2 e 3 te vendimit si dhe me permbajtjen e dispozitave ligjore te lartpermendura.
- Ne apelimin e kemi bere brenda afatit por ja kemi derguar gabimisht jo Drejtorise se Apelimt por Drejtorise Rajonale Tatimore Fier. Me kthimin e pergjigjes se D.R.Tatimore Fier se apelimi duhet ti drejtohet Drejtorise se Apelimt Tirane i kemi kerkuar kesaj te fundit rivendosjen ne afat te apelimt (shih faqen e pare te apelimt dt 15.6.2012) e me pas i kemi kerkuar edhe pranimin ne themel te apelimt (shih faqen e dyte te tij).
- Gjykata ne kundershtim flagrant me dispozitat e mesiperme ka rrezuar padine kur thekson se nga ajo nuk del qe te jete kerkuar rivendosja ne afat e apelimt tatimor. Ky eshte nje lapsus i dukshem i Gjykates sepse rivendosja ne afat e apelimt tatimor nuk kerkohet ne Gjykate me padi por me ankese ne organin administrativ kompetent qe ne rastin tone eshte Drejtoria e Apelimt Tirane. Keshtu, neni 109 i ligjit 9920, dt. 19.5.2008 parashikon te drejten e rivendosjes ne afat sipas procedurave te K.Pr.A. Kete qendrim mban edhe neni 106.2.2 i U.M.F. nr 24,dt. 02.09.2008 ku shprehimisht theksohet se dergimi i apelimt ne Drejtorine Rajonale Tatimore eshte shkak per rivendosjen ne afat te tij kur ky apelimi i dergohet jashte afatit 30 ditor Drejtorise se Apelimt Tirane nga Drejtoria Rajonale Tatimore, si dhe se kjo rivendosje behet sipas neneve 64 e 65 te K.Pr.A. Sipas nenit 65, pika 1 te K.Pr.A. "Kerkesa per rivendosjen ne afat shqyrtohet nga organi qe zhvillon proceduren administrative". Rivendosja ne afat i drejtohet dhe duhet te behet nga Drejtoria e Apelimt Tatimor si organi perkates administrativ qe zhvillon proceduren e shqyrtimit te apelimt.
- Ne Gjykate shkohet vetem per te ankuar vendimin e Drejtorise se Apelimt Tatimor (shih nenin 109.2 te ligjit 9920,dt 19.5.2008) e jo per te kerkuar rivendosjen ne afat te apelimt qe eshte kopetence administrative (ne Gjykate shkohet vetem per te rivendosur ne afat padite). Ne ne padi kemi theksuar se ankohe mi kunder vendimit te Drejtorise se Apelimt Tatimor Tirane edhe per shkak se nuk ka rivendosur ne afat apelimin tatimor ne nje kohe kur nga vete dispozitat e permendura nga ajo Drejtori ne vendimin e saj njihet e drejta e rivendosjes ne afat kur apelimi i drejtohet nje organi tjeter aq me teper kur ai eshte i nje sistemi apo kur vete ne U.M.F. permendet si shkak rivendosjeje dergimi i apelimt gabimisht ne Drejtorite Rajonale Tatimore.
- Vendimi i Gjykates qe ska pranuar padine me arsyetimin se apelimi eshte jashte afatit e se nuk eshte kerkuar me padi ne Gjykate rivendosja ne afat e apelimt, vjen ne kundershtim te hapur me dispozitat e mesiperme ku percaktohet se lejohet rivendosja ne afat kur apelimi i dergohet gabimisht Drejtorise Rajonale Tatimore, se organi qe shqyrton rivendosjen ne afat te apelimt eshte Drejtoria e Apelimt Tatimor e jo gjykata e se ne gjykate ankohet vetem vendimi i Drejtorise se Apelimt.
- Gjykata ka gabuar kur thekson se padia duhet te rrezohet si e pabazuar ne themel duke arsyetuar se "...detyrimi tatimor ...eshte marre ne perputhje me ligjin 9920,dt 19.5.2008.." Ajo ne vendimin e saj nuk i referohet fare pretendimeve tona per aplikim gjobe jashte afatit ligjor por arsyeton vetem se dhenia e gjobes i referohet shkeljeve tona. Pra, Gjykata nuk ka zbatuar fare ne vendimin e saj dispozitat ligjore te lartpermendura e te ngritura nga ana jone ne padi, gjate gjykimit e ne diskutimin perfundimtar. Ne nuk kemi pretenduar asnjehere se skemi bere shkelje por se gjoba eshte dhene me shkelje ligjore apo jashte afatit e se vetem per kete shkak ajo duhet te anulohet.
- Gjykata mban dy qendrame krejt te kunderta ne vendimin e saj. Keshtu kur vjen puna tek apelimi jone thekson se ai nuk pranohet si i bere jashte afatit kurse kur vjen puna tek gjoba nuk

e anullon ate si te dhene jashte afatit.

- Sikurse del nga dosja gjyqesore e nga vete vendimi i Gjykates gjoba (detyrimi tatimor) eshte dhene tej afatit ligjor apo vetem pas 4 muajsh nga dita e konstatimit te shkeljes administrative. Keshtu, sipas nenit 122/a te ligjit 9920, dt 19.5.2008 shkelja e kryer nga ana jone emertohet si kundervajtje administrative kurse sipas nenit 17 te ligjit 10279, dt 20.5.2010 denimi (gjoba) administrative duhet te jepet brenda 1 muaji nga dita e konstatimit.
- Perfundimisht, vendimi i Gjykates qe e ka cilesuar gjoben (detyrimin tatimor) si te bazuar ne ligj vjen ne kundërshtim me dispozitat ligjore te lartpermendura te cilat nuk lejojne dhenien e nje gjobe per shkelje (kundervajtje) administrative pas nje muaji nga dita e konstatimit te shkeljes.
- Gjykata ka gabuar edhe ne ngarkimin tone me shpenzimet gjyqesore duke zbatuar gabim nenin 106 te K.PR.C. Me kerkimin e ndryshimit te vendimit duke u vendosur pranimi i padise rrjedh edhe kerkesa per ngarkimin e shpenzimeve gjyqesore e avokatore pales se paditur.

Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin Nr. 687/60-2014-960 datë 17.04.2014 ka vendosur “Moskompetencën e Gjykatës së Apelit Vlorë për gjykimin e çështjes civile me nr. 2438 regjistri me datë regjistrimi 30.11.2012. Dërgimin e akteve të kësaj çështje civile për kompetenë Gjykatës Administrative të Apelit”.

Gjykata Administrative e Apelit;

Si u njoh me relatimin e **gjyqtares Rilinda Selimi**, shqyrtoi aktet e dosjes dhe analizoi çështjen ne tërësi;

V Ë R E N

Referuar akteve që ndodhen në dosje rezulton se pala paditëse shoqeria “Çeliku” sh.p.k. Fier është themeluar në datë 20.10.1997 dhe është regjistruar në Qendra Kombetare e Rregjistrimit Tirane me NIPT J72510403S. Kjo shoqëri ushtron aktivitetin e saj në fushën e tregtimit të artikujve te ndryshem ushqimore, tregetim pijesh alkolike, karburante te ndryshem etj, me seli në Komunen Qender Fier.

Nga inspektorët e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në datë 13.06.2011 është ushtruar kontroll prane aktivitetit te paditesit në lidhje me pajisjen ose jo me kasa fiskale. Lidhur me kontrollin e ushtruar nga ana e pales se paditur eshte mbajtur akt-konstatimi date 13.06.2011 ku permbahen keto konstatime;

- kjo shoqëri nuk ka instaluar kasën fiskale në një grup gazi, i cili është në gjendje pune dhe nuk është i lidhur me kasë fiskale si dhe;
- ka punëtorë të pa deklaruar.

Mbi bazen e këtij akt konstatimi, eshte hartuar njoftim vleresimi tatimor me Nr. 6939 Prot. date 13.10.2011 me ane te te cilit pala paditese detyrohet te paguaje gjoben ne masen 107.441 leke për punonjës të pa deklaruar dhe 100.000 lekë dënim për pajisje fiskale.

Nga ana e paditësit, me kërkesën datë 10.01.2012 është ushtruar ankim administrativ ndaj ketij akti per penalitetin gjobe 100.000 leke. Ankimi rezulton te jete paraqitur prane DRT Fier, per fatin e te cilit paditesi njoftohet me shkresen Nr. 1463/1, datë 12.06.2012 me orientimin se duhet ti drejtohej Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë.

Pas kesaj paditesi e ka depozituar ankimin pranë Drejtorisë së Apelitit Tatimor e cila me shkresë nr.13185/3 prot. date 10.09.2012 e njofton për refuzimin e ankimit në lidhje me njoftim vleresimin për detyrimet tatimore nr.2947 date 21.02.2012, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, në shumën 100.000 leke, pasi konstaton se kërkesa për apelim është bërë jashtë afatit ligjor të përcaktuar në ligjin Nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në R.SH.”.

Për sa më sipër paditësi ka depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier kërkesë padinë me objektin e sipërcituar.

Për sa më sipër pala paditëse në kërkesë padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në shkallë të parë ka pretenduar se:

- Në datë 13.06.2011 është ushtruar një kontroll nga pala e paditur duke u mbajtur dhe një procesverbal ku konstatohet se pala paditëse ka një pajisje të palidhur me kasë fiskale. Për këtë, me aktin Nr. 6939 Prot. date 13.10.2011 jemi gjobitur nga pala e paditur në shumën prej 100.000 lekë. Ky akt na është komunikuar në datë 07.01.2012 dhe pas 3 ditëve kundër tij është bërë ankim duke ja drejtuar atë Drejtorisë Tatimore Fier dhe jo Drejtorisë së Apelitit Tiranë. Sikurse rezulton nga aktet e administruara në dosje, pala paditëse ka bërë apelim brenda 3 ditësh. Pala e paditur nuk ja ka dërguar për kompetencë Drejtorisë së Apelitit Tatimor Tiranë, megjithëse kishte 25 ditë kohë.
- Apeli duhet të pranohej në themel duke u anuluar gjoba sepse dhënia e saj është bërë tej afatit ligjor të parashikuar në nenin 17 të ligjit 10279 datë 20.5.2010 “Për kundravajtjet administrative” në lidhje me nenin 122/a të ligjit 9920 datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore” (i ndryshuar me ligjin 10209 datë 23.12.2009).
- Pala e paditur e ka konstatuar shkeljen administrative në datë 13.6.2011 ndërsa gjobën e ka dhënë në datë 13.10.2011 ose katër muaj pas konstatimit. Kjo gjobë është dhënë tej afatit njëmuajor dhe duhet të anulohet vetëm për këtë fakt. Sipas dispozitës së parë afati për dënimin administrative parashikohet taksative për një muaj nga dita e konstatimit ndërsa sipas dispozitës së dytë mosvendosja e një kase fiskale është kundravajtje administrative.
- Pala e paditur pretendon se nuk ka afat të përcaktuar në dhënien e gjobës në raport me kohën e konstatimit të shkeljes e kjo mungesë është në ligjin 9920 datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore” Është e vërtetë se në ligjin e lartpërmendur nuk përcaktohet shprehimisht afati në dhënien e gjobës por në këtë ligj thuhet shprehimisht se shkelja e kryer nga pala paditëse është kundravajtje administrative. Kurse në ligjin specifik për kundravajtjet administrative përkatësisht nenin 17 të ligjit 10279 datë 20.05.2010 thuhet shprehimisht se gjoba për kundravajtjet administrative duhet të jepet Brenda një afati një muajor nga dita e konstatimit.

Pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, ka prapësuar se:

- Paditësi me NIPT J72510403S është regjistruar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier si biznes i madh me TVSH në 04.11.1997 me aktivitet “Tregëtim artikujsh të ndryshëm ushqimor, import-eksport, tregëtim pijesh alkoolike, cigare, karburante të ndryshëm, makineri të ndryshme, pajisje elektroshtëpiake, material ndërtimi”.
- Në datë 13.06.2011 paditësit i është ushtruar një kontroll nga ana e Inspektorëve të Verifikimit në Terren pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier dhe për këtë është mbajtur akt konstatimi me Nr. 0171873 datë 13.06.2012, për mospasje kasë fiskale. Me anë të njoftim vleresimi tatimor me Nr. 6939 Prot. date 13.10.2011 paditësi është gjobitur me një gjobë me vlerë 100 000 lekë.
- Ankimi i paditësit është depozituar pranë Drejtorisë së Apelitit Tatimor tej afatit 30 ditor dhe pretendimi i palës paditëse për rivendosje në afat të ankimit është në kundërshtim me ligjin

9920/2008, nenin 106.

- çështja nuk bën pjesë në juridiksionin gjyqësor pasi nuk është ezauruar rruga administrative.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin Nr. 62-2012-6115(2102), datë 30.10.2012 ka vendosur rrëzimin e padisë ne te gjitha kerkimet e saj, si padi, e cila nuk mund te ngrihej dhe e pabazuar ne prova e ne ligj.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, në lidhje me këtë vendim ka arsyetuar se:

“Ligji Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, ka përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e tatimpaguesve si dhe të organeve tatimore.

Një prej detyrimeve të tatimpaguesit sipas nenit 55 të këtij ligji, është detyrimi për përdorimin e pajisjeve fiskale.

Në funksion të Ligjit nr.9920 ka dalë dhe Vendimi nr.781, datë 14.11.2007, i Këshillit të Ministrave, “Për Karakteristikat Teknike e Funksionale të Pajisjeve Fiskale, Sistemit të Integruar të Kompjuterizuar për Transferimet Periodike, Automatike, të Deklarimeve Financiare, Sistemit të Komunikimit, për Procedurën e Dokumentacionin për Miratimin e Tyre dhe për Kriteret për Pajisjen, me Autorizim, të Shoqërive të Auatorizuar për Ofrimin e Pajisjeve Fiskale”.

Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.781, datë 14.11.2007, me ndryshimet përkatëse:

“Personat, juridikë dhe fizikë, që do të mbajnë të dhënat e xhiros, nëpërmjet regjistruarit elektronik, janë të detyruar të mbajnë regjistrimet, në përputhje me kërkesat e këtij vendimi, sipas kalendarit të mëposhtëm:

b) Brenda periudhës janar-dhjetor 2009, personat e regjistruar për TVSH-në dhe tatimpagues të tatimit mbi fitimin, të cilët administrohen nga drejtoritë e tjera Rajonale Tatimore”.

Nga kontrolli i ushtruar prej inspektorëve të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Fier ka rezultuar se subjekti Shoqeria “Çeliku” shpk Fier, nuk ka instaluar pajisjen fiskale për regjistrimin e pagesave me para në dorë, gjithashtu është gjetur punetori Pandeli Prifti, i padeklaruar ne skemen e sigurimeve shoqerore dhe shendetsore, kjo nga verifikimi ne listpagesen e muajit Qershor 2011.

Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.781 datë 14.11.2007, paditësi ka pasur detyrimin për të instaluar pajisjen fiskale për regjistrimin e pagesave me para në dorë deri në dhjetor 2009, detyrim, i cili nuk është përmbushur, gjithashtu te mos mbaje punonjes te padeklaruar ne skemen e sigurimeve shoqerore dhe shendetsore.

Në këto kushte Njoftim vleresimi për detyrim tatimor nr. 2947 prot. dt.21.02.2012, me të cilin detyrohet paditësi në shumën 100.000 lekë, është marrë në përputhje me Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”. Pala paditese i eshte drejtuar Drejtorise se Apelimit Tatimor Tirane, me kerkese date 15.06.2012, e protokolluar kjo me nr.13185 date 18.06.2012, prane kesaj Drejtorie. Kjo kerkese per apelim eshte jashte afateve ligjore te parashikuara ne nenin 106 te ligjit nr. 9920 date 19.05.2008 “Per Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqiperise” dhe pikes 106.3.1, te Udhezimit, ne zbatim te ketij ligji, gjithashtu te pikes 106.2.2 te Kreut VI te udhezimit nr.24 date 02.09.2008 “Per Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqiperise”.

Ne keto kushte, Drejtoria e Apelimit Tatimor prane Drejtorise se Pergjithshme Tirane, i ka refuzuar ankimin pales paditese, e ne keto kushte gjykata konkludon se kjo padi nuk mund te ngrihej, duke

konkluduar gjithashtu se padia eshte edhe e pabazuar ne prova e ne ligj. Me padine objekt gjykimi, pala paditese nuk ka kerkuar rivendosjen ne afat, bazuar nenin 109 te Ligjit Nr.9920 date 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", si dhe ne nenet 64 e 65 te K.Pr.Administrative".

Kolegji Administrativ i Apelit, si vleresoi materialet e ceshtjes, cmon se kerkimi i paditesit per shfuqizimin si akt administrativ te shkreses Nr.6939 date 13.10.2011 nuk mund te ngrihet me pasoje prishjen e vendimit dhe pushimin e gjykimit te ceshtjes.

Konstatohet se ne vendimin objekt ankimi gjykata e shkalles se pare ka dhene te njejtin cilesim, por mbi bazen e mosshqyrtimit te ankimit administrativ sipas vendimit te Drejtorise se Apelimit Tatimor per shkak paraqitje te ketij ankimi tej afatit ligjor. Kolegji vlereson se, pavaresisht konkludimit te njejte se ceshtja nuk eshte e pranueshme per t'u parashtruar gjyqesisht, thekson se nje perfundim te tille e arrin mbi nje tjetër arsyetim dhe shkak.

Perkatesisht, Kolegji vlereson se jemi përpara nje padie që nuk mund te ngrihet per shkak se akti i kundërshtuar ne padi nuk perben akt administrativ. Ne nenin 106 te Ligjit nr. 9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar percaktohet se

"1. Tatimpaguesi mund të ankimojë kundër çdo njoftim vlerësimi, çdo vendimi që ndikon në detyrimin e tij tatimor, çdo kërkesë për rimbursim ose lehtësim tatimor, ose çdo akti ekzekutiv të posaçëm tatimor, në lidhje me tatimpaguesin.

2. Ankimi bëhet me shkrim dhe në formën e parashikuar në zbatim të këtij ligji, me udhëzim të Ministrit të Financave.

3. Tatimpaguesi e dorëzon ankimin në drejtorinë e apelimit tatimor brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur vlerësimi ose vendimi i administratës tatimore është marrë ose vlerësohet të jetë marrë nga tatimpaguesi.

4. Drejtoria e apelimit i dërgon një kopje të ankimit administratës tatimore, që ka nxjerrë vlerësimin tatimor ose vendimin, objekt të ankimit tatimor."

Ne nenin 109/ 2 te ligjit parashikohet se:

" Tatimpaguesi mund ta kundërshtojë vendimin e drejtorisë së apelimit tatimor në gjykatë, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni për këtë vendim. Nëse drejtoria e apelimit tatimor nuk shprehet brenda tre muajve nga data e marrjes së ankimit, tatimpaguesi mund të ankohet drejtpërdrejt në gjykatë."

Dispozitat e mësipërme rregullojnë shqyrtimin e kundërshtimeve te tatimpaguesit te detyrimeve tatimore fillimisht ne organin me te larte administrativ e me pas ne gjykate ne shprehje te parimit kushtetues te kontrollit (te brendshem administrativ dhe atij gjyqësor) te veprimtarise administrative, sanksionuar ne nenin 18 te K.Pr.Administrative.

Nderkaq ligji i posacem ka percaktuar aktet ndaj te cilat veprojne kundërshtimet e tatimpaguesit cilesuar *"çdo njoftim vlerësimi, çdo vendimi që ndikon në detyrimin e tij tatimor, çdo kërkesë për rimbursim ose lehtësim tatimor, ose çdo akti ekzekutiv të posaçëm tatimor, në lidhje me tatimpaguesin."*

Qëllimi i ketij rregullimi konfirmon natyren që duhet te gezoje akti administrativ si akt juridik qe krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie të caktuar juridike. Ky element juridik është shkak përcaktues

për ardhjen e pasojave juridike, duke qënë se është shfaqje e pushtetit shtetëror përmes organit administrativ që i njihet kompetenca dhe e drejta për të vepruar si i tillë.

Shumë nga veprimet e administratës publike dhe e punonjësve të saj janë veprime të një karakteri material dhe të tjera janë me karakter teknik. Vetëm ajo veprimtari administrative që sjell lindje, ndryshim ose shuarje të pasojave juridike do të konsiderohet veprimtari juridike. Çdo akt tjetër që nuk deklaron vullnet juridik të organit administrativ, nuk gezon fuqinë juridike të aktit administrativ.

Kodi i Procedurave Administrative e më tej edhe ligji nr. 49/2012 përcakton se "Akt administrativ individual" është çdo vullnet i shprehur nga organi publik, në ushtrim të funksionit të tij publik, ndaj një ose disa subjekteve individualisht të përcaktuara të së drejtës, që krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete."

Në rastin në shqyrtim, rezulton se përmes padise paditese rezulton të ketë kundërshtuar si akt administrativ shkresën Nr.6939 datë 13.10.2011 e cila përben një akt vlerësimi të kryer nga punonjësit e Drejtorisë së Përpunimit dhe Menaxhimit të të Ardhurave e DRT Fier mbi konstatimin e një punonjësi të padëklaruar nga shoqëria shtuar dhe penalitetin prej 100.000 leke për mospajisje me kase fiskale.

Si i tillë ky akt nuk përmbush karakterin juridik të aktit administrativ e për pasojë kundërshtimi I tij në gjykatë nuk mund të ngrihet nga shoqëria paditese në veshtrim të nenit 324 e vijues të K.pr.Civile në lidhje me nenet 109 të Ligjit nr. 9920/2008.

Mosmarrëveshja në këtë rast nuk plotëson kërkesat e nenit 109/2 midis tatimpaguesit, person juridik tregtar dhe organit tatimor për kundërshtimin e penalitetit 100.000 leke, duke qënë se akti që ngarkon shoqërinë paditese për pagimin e tij nuk përben objekt të kerkimit gjyqësor e kesisoj, pavarësisht interesit material të paditesit në lidhje me penalitetin, ngritja e kësaj mosmarrëveshje nuk mund t'i shërbejë realizimit të tij (interesit material) për këtë shkak.

PER KETO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, mbështetur në nenin 50, germa "d" të Ligjit nr. 49/2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative",

V E N D O S I

1. Prishjen e vendimit Nr. 62-2012-6115(2102) datë 30.10.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe pushimin e gjykimin të çështjes.
2. Kunder vendimit lejohet rekurs në Gjykatën e Lartë brenda 30 ditëve nga e nesërmeja e njoftimit të tij.

U shpall në Tiranë, sot më 30.09.2015.

ANETARE
Alkelina GAZIDEDJA
Dv

ANETARE
Blerona HASA
dv

KRYESUESE
Rilinda SELIMI
Dv

E NJESUAR ME ORIGINALIN

Kancelari
Leonard Steadaj
Steadaj